



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 260

Tiranë – E hënë, 9 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 927, datë 21.12.2016	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Panajot Boga..... 26547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 28.12.2016	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë..... 26547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 931, datë 28.12.2016	Për lirim nga detyra..... 26549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 932, datë 28.12.2016	Për një shtesë në vendimin nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 26549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 28.12.2016	Për kalimin në pronësi, nga ministria e mbrojtjes të bashkia Kurbin, të objektit dhe truallit funksional të pronës nr.1148, me emërtim “Ish-Esku”, me vendndodhje në Laç, Kurbin, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe në vendimin nr.467, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”..... 26549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 934, datë 28.12.2016	Për kalimin në pronësi, nga ministria e mbrojtjes të bashkia Poliçan, të pronës nr.1072, me emërtim “Kombinati mekanik, uzina nr.1”, me vendndodhje në Poliçan, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe në vendimin nr.207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Poliçan, të qarkut të Beratit”..... 26551

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 28.12.2016	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ministria e mbrojtjes tek Autoriteti për informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, të objektit nr.52, me emërtim “Arkivi i ri”, brenda territorit të pronës nr.12, me emërtim “komanda e doktrinës dhe stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr.10, rruga e Dibrës, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	26553
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 936, datë 28.12.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.....	26555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.939, datë 28.12.2016	Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2017, për Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	26564
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 940, datë 28.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr.884, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit, 2016”.....	26564
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 941, datë 28.12.2016	Për shfuqizimin e vendimit nr.1139, datë 24.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”, të ndryshuar.....	26565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.942, datë 28.12.2016	Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë së llambave dhe të ndriçuesve elektrikë”.....	26565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 944, datë 28.12.2016	Për miratimin e programit dhe të buxhetit të vitit 2017 për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....	26580
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 945, datë 28.12.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për dëmshpërblimin për kafshët e eliminuara”...	26582
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 948, datë 28.12.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë (shtesa)”.....	26583
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 949, datë 28.12.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza lindore Shkodër dhe unaza Shkodër-Rus”.....	26585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 950, datë 28.12.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tre urat Leskovik”.....	26587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 951, datë 28.12.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”.....	26588
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 28.12.2016	Për lirimin dhe emërimin nga/në detyrë të Zëvendëskryetarit dhe të një anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.....	26589
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 28.12.2016	Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016.....	26589

**VENDIM****Nr. 927, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. PANAJOT
BOGA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në "Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Panajot Boga, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 930, datë 28.12.2016****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE
TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË
AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA
BASHKIMI EVROPIAN NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr.90/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE-ja, të jetë, gjithsej, 16 veta.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



SKEMA 1

**STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(PROJEKT)**



SKEMA 2

**ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS,
AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS	NUMRI
I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM (TITULLAR INSTITUCIONI)	II - a	1
II. ZËVENDËS DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II - b	1
III. DREJTORIA AUDITIMIT		(6)
AUDITUES TË PARË	II- b	2
AUDITUES TË DYTË	III-a	4
IV. DREJTORIA METODOLOGJISE DHE SIGURIMIT TE CILESISE		(5)
DREJTOR DREJTORIE	II-b	1
AUDITUES TË PARË	II- b	2
AUDITUES TË DYTË	III-a	2
V. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III/1-a	1
SPECIALIST FINANCE	IV-a	1
SPECIALIST I SHËRBIMEVE	IV-a	1
PUNONJËS GJITHSEJ		16

**VENDIM****Nr. 931, datë 28.12.2016****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Olijana Ifti, zëvendësministër i Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 932, datë 28.12.2016**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.718,
DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, të listës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT**

**SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT**

(“LISTA E OKB-së”)

**C) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT
ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

**1. RUSTAM; MAGOMEDOVICH; ASEL-
DEROV**

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM**Nr. 933, datë 28.12.2016**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË BASHKIA
KURBIN, TË OBJEKTIT DHE TRUALLIT
FUNKSIONAL TË PRONËS NR.1148, ME
EMËRTIM “ISH-ESKU”, ME
VENDNDODHJE NË LAÇ, KURBIN, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË
VENDIMIN NR.467, DATË 18.7.2012, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË LAÇ, TË QARKUT TË
LEZHËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes



vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Kurbin, të objektit dhe truallit funksional të pronës nr.1148, me emërtim “Ish-ESKU”, me vendndodhje në Laç, Kurbin, sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për akomodimin e administratës dhe për ushtrimin e funksioneve të veta administrative.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet prona nr.1148, me emërtim “Ish-ESKU”, me vendndodhje në Laç, Kurbin, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në pronësi

ose në përdorim Bashkisë Kurbin, miratuar me vendimin nr.467, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”.

3. Bashkisë Kurbin i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Kurbin, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**VENDIM**

Nr. 934, datë 28.12.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA POLIÇAN, TË PRONËS NR.1072, ME EMËRTIM “KOMBINATI MEKANIK, UZINA NR.1”, ME VENDNDODHJE NË POLIÇAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR.207, DATË 9.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIMTË BASHKISË POLIÇAN, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë

22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Poliçan, të pronës nr.1072, me emërtim “Kombinati Mekanik, Uzina Nr.1”, me vendndodhje në Poliçan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja administrative, për realizimin e funksioneve ekonomike, social-kulturore, për grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtorale dhe për kryerjen e funksioneve të tjera, sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr.1072, me emërtim “Kombinati Mekanik, Uzina Nr.1”, me vendndodhje në Poliçan, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Poliçan, miratuar me vendimin nr. 207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave.




3. Bashkisë Poliçan i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Poliçan, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe

kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**VENDIM****Nr. 935, datë 28.12.2016**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TEK AUTORITETI PËR
INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E
ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT, TË
OBJEKTIT NR.52, ME EMËRTIM “ARKIVI
I RI”, BRENDA TERRITORIT TË
PRONËS NR.12, ME EMËRTIM
“KOMANDA E DOKTRINËS DHE
STËRVITJES”, ME VENDNDODHJE
LAGJJA NR.10, RRUGA E DIBRËS,
TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të

objektit nr.52, me emërtim “Arkivi i ri”, brenda territorit të pronës nr.12, me emërtim “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr.10, Rruga e Dibrës, Tiranë, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ushtrimin e aktivitetit të këtij institucioni, për të cilin është krijuar.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet objekti nr.52, me emërtim “Arkivi i ri”, brenda territorit të pronës nr.12, me emërtim “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr.10, Rruga e Dibrës, Tiranë.

3. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



PLANIMETRIA E PODRUMIT (GJENDJA KZISTUESE) Shk 1:150



KOMANDANTI I KDS

Gjeneral Brigade Manushaqe SHEHU

22.12.16

DREJTORI I IGJIU


N/Kolonel Ark. Ferdi HYRAJ

22.12.16

SHENIM:

Siperfaqe e katit = 946.4 m²Sip. Pergj. Objektit = 2893.2 m²

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (GJENDJA KZISTUESE) Shk 1:150



KOMANDANTI I KDS

Gjeneral Brigade Manushaqe SHEHU

22.12.16


DREJTORI I IGJIU

N/Kolonel Ark. Ferdi HYRAJ

22.12.16

SHENIM:

Siperfaqe e katit = 946.4 m²Sip. Pergj. Objektit = 2893.2 m²

**VENDIM**

Nr. 936, datë 28.12.2016

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në

përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Drejtorinë e Policisë së Shtetit, shtohen pronat, sipas formularëve (fletët 1-6 dhe 9), bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Në listën e inventarit, përmasat e pronës, me emërtimin “Komisariati i Policisë Kamëz”, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara, sipas formularit (fleta 7), bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Në listën e inventarit hiqet prona me emërtimin “ish-Drejtoria e Policisë së Qarkut, Komisariati i Policisë Fier”, me komponentë përbërës, me numrat rendorë 1-16, sipas formularit (fleta 8), bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista përbëhet gjithsej nga 9 (nëntë) fletë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si kases te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MB (Drejtoria Vendore e Policise Elbasan)										
Identifikoi : Drejtori Vendor i Policise Elbasan Kryekomisar Alfred CEPE Drejtori i Policise se Shtetit Drejtues Madhor Hak CAKO Ministri i Punëve te Brendshme Saimir TAHIRI										
Bashkia / Komuna Elbasan										
Fusha e perdorimit te Prones :Ruejto Rendi										
Nr.	Zona Kadastr Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Enerjiesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa vend ndodhja e komponenteve perberes	Pernasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te tjera te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	Z.K. 8525 Ind.Hart eEL-L-9	25/16	Drejtoria Policise Qarkut Elbasan	Zyra ne sherbim te qytetareve	Perendim	144.3	Zyra ne sherbim te qytetareve	Ministria Puneve te Brendshme	Drejtoria Vendore e Policise Elbasan	Ne VKM Nr.250, date 24.04.2003, ndryshuar me miratimin e VKM nr.840, date 14.10.2015, prona Drejtoria Policise Qarkut Elbasan eshte e pasqyruar ne formularin nr.3 te DPQ Elbasan, me nr.rendor 1 - 18.
1				Zyra ne sherbim te qytetareve						Objekti "Godina nr. 14" eshte perfshire ne kete liste inventantizimi me numer rendor 15-F3,me sip 85.8 m² Ne kuader te projekteve "Krijimi i zyrave ne sherbim te qytetareve", ne vitin 2015 eshte kryer investimi qe perfshin : Prishje Objekti Godina nr 14 me sip 85.5 m² Nderitim objekt te ri Zyra ne sherbim te qytetarit me sip 144.3 m²



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Identifikoi : Drejtori Përgjithshëm për Shërbimet Mbështetëse Drejtues i Lartë Ylli IMERI Drejtori i Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Haki ÇAKO Miratol : Ministri i Punëve të Brendshme Saimir TAHIRI										
Institucioni i Pushtetit Qendror MB (Drejtorja e Policisë Shtetit) Bashkia / (Komuna) Tirane Fusha e përdorimit të Pronës : Institucion/administrata										
A			B			C				
Nr. Rendi	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e pronës Vend ndodhja / Shtirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e pronës ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shenime të vecanta)
1	8150	7/19	Drejtorja e Policisë Shtetit Bulevardi "Bajram Curri"	Godina Hyrjes		30.5	Oficer Roje	Ministria e Punëve të Brendshme	DPShtetit	Pasuria nr.7/19, ne Zon kad. 8150, e DPShtetit perfishihet ne listen e inventarit te miratua me VKM Nr.317, date 21.04.2011, (formulari inventarizimit "3" me nr rendor 1 - 4).
2				Mur rrethues		280 ml	Rrethimi Institucionit	Ministria e Punëve të Brendshme	DPShtetit	Objekti "Godina Oficeri Rojes" eshte perfshire ne kete liste me nr.3 dhe me sip.12 m²
										Ne kuader te zbatimit te projektit me objekt : "Sistemimi i hyrjes se Drejtorise Policise Shtetit" miratuar me Vendimin KKT nr.4, dt.09.09.2015 eshte kryer investimi qe perfishin : Prishje Objekti Godina "Oficeri Rojes" nr.3 me sip 12 m² Nderitim objekt te ri Godina "Oficeri Rojes" me sip 30.5 m²
										Ne kontabilitet te DPShtetit eshte prona "Mur rrethues" qe nuk perfishihet ne listen e inventarit te miratuar me VKM Mur rrethues me gjatesi 280 ml



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucioni / Pushtetit Vendor MPB (Komisariati NSH - Fier) Bashkia / Komuna Mbrostar (Fshati Vajkan) - Fier Fusha e perdorimit te Prones : Ruajtje Rendi				Identifikoi : Shefi i Komisariatit te Policise NSH-Fier Kryekomisar Artur SELIMAJ Drejtori i Policise se Shetit Drejtues Madhor Haki ÇAKO Ministri i Puneve te Brendshme Saimir TAHIRI						
A			B			C			Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
Nr. Rendi	Zona Kadas. Indeksi / Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative		Institucioni / Enti per dorues Statusi juridik i perdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3595 K-34-112 148-C	83		Poligon qitje Komuna Mbrostar Fshati Vajkan	5 550		Poligon	Ministria e Puneve te Brendshme	Komisariati Policise NSH-Fier	Prona "Poligoni i qitjes" perfshihet ne listen paraprake te pronave te paluajtshme ne pronesi te Komunes Mbrostar, miratuar me VKM nr.622, date 04.08.2010 Me Vendimin nr.12, dt.17.02.2014, te Komunes Mbrostar eshte miratuar transferimi i prones "Poligon qitje", ne fshatin Vajkan, ne pergjegjesi administrimi te MPB



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MB (DRKufirit dhe Migracionit Vlore)		Identifikoi :		Drejtori i DRK&M Vlore Kryekomisar <i>Gezim ZHUPAJ</i>						
Bashkia / Komuna Rradhime		Miratoi :		Drejtori i Policise se Shtetit Drejtues Madhor Haki ÇAKO						
Fusha e perdorimit te Prones : Ruajtje Kufiri		Miratoi :		Ministri i Puneve të Brendshme Saimir TAHIRI						
Nr. Rend	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrija Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni i perdorues Statusi juridik i perdorimit	Shenime te vecanta (Shenime te vecanta)
1		3	4	5	6	7	8	9	10	11
			SML Rradhime							Ne VKM Nr. 250, dt. 24.04.2003, perfshihet prona PK Rradhime, ne formularin 1 te inventarizimit me nr. rendor 6 (F-1) DPQ Vlore (Tualli me sip. 3000 m ² dhe objekti me siperaqe 82m ²) Kjo prone aktualisht eshte ne inventar te DRKM Vlore.
5				Depo				Ministria e Puneve te Brendshme	DRK&M Vlore	Brenda siperfaqes se tualtit te PK Rradhime, ndodhen dhe nje objekt tjeter "Depo " qe eshte ne kontabilitet te kesaj njesie: Sip. Depo - m ²
										Ne VKM nr. 840, dt. 14.10.2015, ne inventar te DRKM Vlore, objekti "Kashun qeni" PK Himare ne F-3, eshte perfshire ne nr. rendor 4 dhe perseritur gabimisht me nr. rendor 5, duke lene te paperfshire objektin Depo-Rradhime
										Ky formular sherben per te korrigjuar gabimin e kryer, duke zevendesuar/perfshire objektin Depo - SML Rradhime me nr. rendor 5



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MB (Drejtoria Vendore e Policise Tirane)				Identifikoi :				Miratoi :					
Bashkia Tirane				Drejtues Ervin HODAJ				Drejtues Madhor Haki ÇAKO				Ministri i Punëve të Brendshme Saimir TAHIRI	
Fusha e perdorimit te Prones :Ruajtje Rendi													
Nr. Rendi	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funkcioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Shenime te vecanta			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11			
2	Nr.Kad. 8230	Nr.Pas. 6/4	Komisariati Policise Nr.6 Tirane	Truall		3574				Ne zbatim te urdhrat te MPB nr.202, dt.03.05.2016, prona Ish-MNZ Kombinat, ka kaluar ne perdorim te DPShtetit nga Prefektuar Tirane. Prona nuk shite e perfishire ne listen e inventarit te pronave te miratuat ne VKM			
3			Godina Kryesore 2-kat	Zyra Administrative	Jug-Lindje	412.4		MPB	DVP Tirane	Mbeshtetur ne konfirmimin e dhene nga ZVRPP prona "Komisariati Policise nr.6 Tirane", duhet te perfishihet ne listen e inventarit te pasurise ne administrim te MPB, ne perdorim te DPShtetit (DVP Tirane)			
4			Garazhdi	Garazhd		148.1		MPB	DVP Tirane				
5			Zyra Informacionit	Informacioni		14.8		MPB	DVP Tirane	Objekti/prona qe shihet ne listen e inventarit ka komponente perberes sipas kollones "5" dhe siperfaqe ndertimore sipas kollones "7"			



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MB (Drejtoria Vendore e Policise Tirane)										
Bashkia Tirane										
Fusha e perdorimit te Prones :Ruajtje Rendi										
Nr. Rendi	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrija Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Shenime te vecanta (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Nr.Kad. 8120	Nr.Pas. 5/806	Komisariati Rajonal i Policise Rrugore Tirane	Zyra Pritjes Qytetareve & Administrative	Jug-Lindje	343.2	Sherbim komuniteti Administrative	MPB	DVP Tirane	Ne VKM Nr.250, dt.24.04.2003, te ndryshuar, perfshihet prona e Komisariatit Rajonal te Policise Rrugore, ne formularin 3 te inventarizimit te pasurise, te DVP Tirane me siperaqe totale 2055 m ² , sipas dokumentit hipotekor Certificate Prona 1014326, dt.19.01.2015
										Ne kuader te strategjise se Policimit ne Komunitet mbeshetur financiarisht nga donatore potencial u perfutua investimi , ndertim objekti 2-kat
										Me perfundimin e investimit, objekti duhet te perfshihet ne listen e inventarit te pronave ne administrim te MPB, ne perdorim te DPShtetit (DVP Tirane)
										Objekti/prona qe shihet ne listen e inventarit ka komponente perberes sipas kolones "5" dhe siperfaqe ndertimore sipas kolones "7"

Identifikoi : **Drejtori i DVP Tirane**
Drejtes Ervin HODAJ

Drejtori i Policise se Shtetit
Drejtes Madhor Haki ÇAKO

Miratoi : **Ministri i Punëve të Brendshme**
Saimir TAHIRI



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

A		B			C			Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)		
Nr. Rend	Zona Kadas. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona		Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Nr.Kad. 2066	92/1		Komisariati Policise Kamez	766	523.15	Zyra administrative	MPB	DVP Tirane	Prona e Komisaritit te Policise Kamez perfishihet ne listen e inventarit te pasurise miratuar me VKM nr.317, dt.21.04.2014 dhe posedon dokument hipotekor Certifikate Pronesie nr.856768, dt.05.05.2014 me siperfaqe totale trualli 621m² Nga konfirmimet e marra ne ZVRPP se fundi rezulton se: siperfaqja totale e truallit eshte 766 m² Per kele del e domosdoshme ndryshimi i VKM per saktesimin e siperfaqes se truallit

Identifikoi :
Drejtori i DVP Tirane
Drejtues Ervin HODAJ

Drejtori i Policise se Shtetit
Drejtues Madhor Haki CAKO

Miratoi :
Ministri i Punëve të Brendshme
Saimir TAHIRI

Institucioni i Pushtetit Vendor MPB (DVP Tirane)

Bashkia / Komuna Kamez

Fusha e perdorimit te Prones : Ruajtje Rendit



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni I Pushtetit Qendror MB (Drejtoria Vendore e Policise Fier)				Identifikoi :				Drejtori i DVP Fier Drejtues i Pare Neritan NALLBATI			
Bashkia / Komuna Fier				Drejtori i Policise se Shtetit Drejtues Madhor Haki ÇAKO				Ministri i Punëve të Brendshme Saimir TAHIRI			
Fusha e perdorimit te Prones :Rruajtje Rendi				Miratoi :							
Nr. Rend	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shemime te vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	8534	4/37		Godina qendrore	Qender	550.6	heqje inventari	MPB	DVP Fier	Sipas VKM nr.250 dt.24.04.2003 ndryshuar pershihet prona Drejtoria Policise Fier	
2				Godina kufirit	Lindje	262.2	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
3				Godina prapavijes	Perendim	271.3	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
4				Godina garazhde	Veri-Lindje	283	heqje inventari	MPB	DVP Fier	Ne zbatim te urdhrat te Ministrit te PB nr.341, dt.08.07.2016 "Per heqjen nga inventari te disa pronave te DVP Fier"	
5				Lavanderi, fjetore	Lindje	117.7	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
6				Zyra, magazine	Jug-Perendim	59.7	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
7				Fjetore, magazine	Jug-Lindje	512.8	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
8				Palester, kartoteke	Veri	564.2	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
9				Mence - kuzhine	Lindje	98	heqje inventari	MPB	DVP Fier	Prona qe kerkohet te hiqet nga lista e inventarit te MPB perbehet me komponentet perberes te saj sipas kolones "5" dhe me permasat e prones sipas kolones "7"	
10				Tualet	Lindje	20	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
11				Pike karburanti	Lindje	12	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
12				Lulishte	Jug	80	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
13				Parking mjetes	Jug	500	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
14				Mur rrethues	Perendim	85	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
15				Mur rrethues		42.5	heqje inventari	MPB	DVP Fier		
16				Rruge truall I lire		10.296	heqje inventari	MPB	DVP Fier		



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

INSTITUCIONI I PUSHTETIT QENDROR: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
BASHKIA TIRANË

Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadastr. & Indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8150	1/60 vol 30 fq 36	Vend strehim	Venddrejtimi kryesor i MPB Objekti Shtylla Bulevardi Dëshmoret e Kombit	1022	1022	Ambiente nëntokësore	Ministria e Punëve të Brendshme	Ministria e Punëve të Brendshme	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

VENDIM

Nr.939, datë 28.12.2016

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE OPERATIVE, PËR VITIN 2017, PËR ENTIN RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2017, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 47 323 000 (dyzet e shtatë milionë e treqind e njëzet e tre mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)
Pasqyra Nr. 1/1

PLANI SHPENZIMEVE OPERATIVE PËR VITIN 2017

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2017 (në mijë lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	30,210
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,145
3.	Shërbime e furniturë	11,178
4.	Investime	790
	TOTALI	47,323

VENDIM

Nr. 940, datë 28.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.884, DATË 16.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPËRBLIMIN DHE KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E FUNDVITIT, 2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.884, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

“Efektet financiare të përballohen në masën 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe në masën 122 000 000 (njëqind e njëzet e dy milionë) lekë nga fondi i kontingjencës, të miratuar për vitin 2016. Pjesa tjetër të përballohet nga buxheti i vitit 2016, zëri “Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë”, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 941, datë 28.12.2016**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT
NR.1139, DATË 24.11.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË AUTOMJETEVE DHE TË
SHOFERËVE NË DISPOZICION TË
MINISTRIVE DHE TË
INSTITUCIONEVE QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimi nr.1139, datë 24.11.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore që, brenda datës 15 janar 2017, të dorëzojnë në Ministrinë e Financave të dhënat në nivel ministrie/institucioni qendror të pavarur për:

- numrin aktual të mjeteve të transportit në dispozicion;

- numrin e punonjësve në funksionin “shofer”, miratuar në strukturën organike aktuale.

3. Ngarkohet Ministria e Financave që të iniciojë vendimin përkatës për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr.942, datë 28.12.2016**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK
“PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË SË
LLAMBAVE DHE TË NDRIÇUESVE
ELEKTRIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të

produkteve me ndikim në energji”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë së llambave dhe të ndriçuesve elektrikë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**RREGULL TEKNIK
“PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË SË
LLAMBAVE DHE TË NDRIÇUESVE
ELEKTRIKË”***

1. Objekti dhe fusha e përdorimit

1. Ky rregull teknik përcakton kërkesat për etiketimin dhe informacionin plotësues për llambat elektrike, të tilla si:

- a) llambat me filament (inkadeshente);
- b) llambat fluoreshente;
- c) llambat me intesitet të lartë shkarkimi;
- ç) llambat LED dhe modulet LED.

Ky rregull teknik përcakton, gjithashtu, dhe kërkesat për etiketimin e ndriçuesve, të modeluar për të funksionuar me këto llamba dhe të tregtuar te përdoruesit fundorë, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë të integruara në produkte të tjera, që nuk varen nga inputi i energjisë elektrike në plotësimin e qëllimit të tyre kryesor gjatë përdorimit (të tilla si mobilje).

2. Nga fusha e zbatimit e këtij rregulli teknik përjashtohen produktet e mëposhtme:

- a) llambat dhe modulet LED me fluks drite më pak se 30 lumen;

* Rregulli teknik është përafëruar pjesërisht me Rregulloren Evropiane 874/2012 të Komisionit, datë 12 korrik 2012, që plotëson Direktivën 2010/30 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me etiketimin e energjisë së llambave dhe ndriçuesve elektrikë, e amenduar nga Rregullorja e Deleguar e Komisionit (EU), Nr.518/2014, e datës 5 mars 2014, lidhur me etiketimin e energjisë në internet.
CELEX 32012R0874 – EN Fletorja Zyrtare e Unionit Evropian, Seria L 258 faqe 1 – 20.



b) llambat dhe modulet LED të tregtuara për funksionim me bateri;

c) llambat dhe modulet LED të tregtuara për përdorime ku ndriçimi nuk është qëllimi i tyre kryesor, të tilla si:

i) emetimi i dritës si një agent në proceset kimike ose biologjike (të tilla si polimerizimi, terapia fotodinamike, hortikultura, kujdesi i kafshëve shtëpiake, produkte kundër insekteve);

ii) kapja e imazheve dhe projektimi i imazheve (të tilla si blicet e aparateve fotografike, pajisje fotokopjimi, video projektorë);

iii) ngrohje (të tilla si llambat me rreze infra të kuqe);

iv) llamba sinjalizimi (të tilla si llambat sinjalizuese në pista aeroportesh).

Këto llamba dhe modulet LED nuk përjashtohen kur tregtohen për ndriçim.

ç) llambat dhe modulet LED, të tregtuara si pjesë të një ndriçuesi dhe jo të parashikuara për t'u hequr nga përdoruesi fundor, me përjashtim të rasteve kur ofrohen për shitje, dhënie me qira ose blerje me këste, apo ekspozohen të ndara për përdoruesit fundorë, p.sh. si pjesë këmbimi;

d) llambat dhe modulet LED të tregtuara si pjesë të një produkti, qëllimi kryesor i të cilit nuk është ndriçimi. Megjithatë, nëse ato ofrohen për shitje, dhënie me qira ose blerje me këste apo ekspozohen më vete, p.sh. si pjesë këmbimi, ato përfshihen brenda fushës së zbatimit të këtij rregulli teknik;

dh) ndriçues që janë modeluar të funksionojnë vetëm me llamba dhe modulet LED të dhëna në shkronjat nga “a” deri në “c”, të kësaj pike.

2. Përkufizime

Përveç termave të përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr.68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, për qëllime të zbatimit vetëm të këtij rregulli teknik termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Burim drite”, një sipërfaqe ose objekt i modeluar të emetojë, kryesisht, rrezatime optike të dukshme, të prodhuar nga transformimi i energjisë. Termi “i dukshëm” i referohet një gjatësie vale 380-780 nm.

2. “Ndriçim”, përdorimi/aplikimi i dritës në një skenë, në objekte ose në mjediset e tyre rrethuese, në mënyrë që të shikohet nga syri i njeriut.

3. “Ndriçim i theksuar”, një formë ndriçimi, në të cilën drita drejtohet në një mënyrë të tillë që të nxjerrë në pah një objekt ose një pjesë të një zone.

4. “Llambë”, një njësi, performanca e së cilës mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur dhe që përbëhet nga një ose më shumë burime drite. Ajo mund të përfshijë komponentë shtesë të nevojshëm për ndezjen, furnizimin me energji elektrike, funksionimin e qëndrueshëm të njësisë ose për shpërndarjen, filtrimin ose transformimin e rrezatimit optik në rastet kur këto komponentë nuk mund të hiqen pa dëmtuar përgjithmonë njësinë.

5. “Kapuç (xokol) e llambës”, pjesa e llambës që siguron lidhjen me furnizimin elektrik nëpërmjet një portollambë dhe mund të shërbejë për mbajtjen e llambës brenda portollambës.

6. “Portollambë”, një pajisje që mban llambën në pozicion, zakonisht duke pasur xokolën të fiksuar në të. Në çdo rast ajo shërben si mjet për lidhjen e llambës me furnizimin elektrik.

7. “Llambë drejtuese”, një llambë që ka, të paktën, 80% dritë brenda një këndi të pandryshueshëm π sr (që i korrespondon një koni me kënd 120°).

8. “Llambë jodrejtuese”, llambë që nuk është llambë drejtuese.

9. “Llambë me filament”, llamba, në të cilën drita prodhohet nëpërmjet një përcjellësi në formën e një teli të hollë, që ngrohet deri në skuqje nga kalimi i rrymës elektrike. Llamba mund të përmbajë gaze që ndihmojnë procesin e skuqjes.

10. “Llambë inkadeshente”, llambë me filament, në të cilën filamenti funksionon brenda një poçi me vakum ose i rrethuar nga gazi inert.

11. “Llambë halogjene (volfram)”, llambë me filament, në të cilën filamenti është prej volframi dhe i rrethuar nga gaze që përmbajnë halogjene ose lidhje halogjene. Këto llamba mund të furnizohen me një burim elektrik të integruar.

12. “Llambë me shkarkesë në gaz”, llambë, në të cilën drita prodhohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një shkarkim elektrik, nëpërmjet një gazi, avulli metalik ose një përzierje të disa gazeve dhe avujve.

13. “Llambë fluoreshente”, llambë me shkarkesë në gaz, e tipit me merkur në presion të ulët, në të cilën shumica e dritës emetohet nga një ose më shumë shtresa fosfori të ngacmuara nga rrezatimi ultravjollcë, i gjeneruar nga shkarkesa. Llambat fluoreshente mund të jenë të integruara me një drosel.



14. “Llambë fluoreshente pa drosel të integruar”, llambë fluoreshente me një ose dy xokola pa drosel të integruar.

15. “Llambë me shkarkesë në gaz me intesitet të lartë”, llambë me shkarkesë elektrike, në të cilën harku që prodhon dritën formohet nga efekti termik i mureve të ballonit dhe harku ka ngarkesë sipërfaqësore më të madhe se 3 wat/cm^2 .

16. “Diodë emetuese e dritës (LED)”, një burim drite që përbëhet nga elemente në gjendje solide, që ka lidhje p-n. Lidhja lëshon rrezatim optik kur ngacmohet nga një rrymë elektrike.

17. “Paketa LED”, një grup që ka një ose më shumë LED. Grupi mund të përfshijë një element optik dhe ndërfaqe termike, mekanike dhe elektrike.

18. “Moduli LED”, një grup që nuk ka xokol dhe që përfshin një ose më shumë paketa LED të fiksuara mbi një qark të stampuar. Grupi mund të ketë komponentë elektrikë, optikë, mekanikë dhe termikë, ndërfaqe dhe njësi kontrolli.

19. “Llambë LED”, llambë që përfshin një ose më shumë module LED. Llamba mund të jetë e pajisur me një xokol.

20. “Njësi kontrolli e llambës”, një pajisje e vendosur ndërmjet ushqimit elektrik dhe një ose më shumë llambave, e cila siguron funksionalitetin në lidhje me punën e llambës/ave, si p.sh. transformimi i tensionit të ushqimit, kufizimi i rrymës së Llambës/ave në vlerën e kërkuar, sigurimi i tensionit të ndezjes dhe rrymës së parangrohjes, parandalimi i ndezjes në të ftohtë, korrigjimi i faktorit të fuqisë ose reduktimi i zhurmave ndërhyrjeve radio. Pajisja mund të projektohet që të lidhet me një njësi tjetër kontrolli për llamba për të kryer këto funksione. Termi nuk përfshin:

a) pajisjet e kontrollit;

b) furnizimet elektrike që shndërrojnë tensionin e rjetit në një tension tjetër të ushqimit, të parashikuar për të furnizuar të njëjtin instalim, si produktet e ndriçimit ashtu dhe produktet, qëllimi kryesor i të cilave nuk është ndriçimi.

21. “Pajisje kontrolli”, një pajisje elektronike ose mekanike, që kontrollon ose monitoron fluksin e dritës së llambës nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ai i shndërrimit të fuqisë së llambës, si p.sh. çelësat rele të kohës, sensorët e pranisë, sensorët e dritës dhe pajisjet e rregullimit të ndriçimit sipas dritës së ditës. Përveç kësaj, edhe errësuesit e dritës

me prerje faze konsiderohen si pajisje kontrolli.

22. “Pajisje e jashtme e kontrollit të llambës”, një pajisje kontrolli e një llambe jo të integruar, e projektuar të montohet jashtë ballonit të llambës ose ndriçuesit, ose që hiqet nga balloni pa e dëmtuar përgjithmonë llambën ose ndriçuesin.

23. “Drosel”, pajisja që vendoset ndërmjet burimit të tensionit dhe një ose disa llambave me shkarkesë në gaze, i cili, në sajë të induktivitetit, kapacitetit ose të kombinimit të induktivitetit dhe kapacitetit shërben, kryesisht, për të kufizuar rrymën e llambës/ave që të mos kalojë një vlerë të caktuar.

24. “Pajisje kontrolli e Llambës halogjene”, një pajisje kontrolli e llambës, që transformon tensionin e rjetit në tension shumë të ulët për llamba halogjene.

25. “Llambë fluoreshente kompakte”, një llambë fluoreshente, që përfshin të gjithë komponentët e nevojshëm për ndezjen e funksionimin e qëndrueshëm të llambës.

26. “Ndriçues”, një aparat, i cili shpërndan, filtron ose transformon dritën e lëshuar nga një ose më shumë llamba dhe që përfshin të gjithë pjesët e nevojshme për mbështetjen, fiksimin e mbrojtjen e llambave dhe, kur është e nevojshme, të pjesëve ndihmëse të qarkut, së bashku me mjetet për lidhjen e tyre me furnizimin elektrik.

27. “Pikë shitje”, një vendndodhje fizike, ku produkti ekspozohet ose ofrohet për shitje, jepet me qira ose shitet me këste për përdoruesin fundor.

28. “Përdorues fundor”, një person fizik, që ble ose parashikon të blejë një Llambë elektrike ose ndriçues jo për qëllime tregtare, biznesi artizanal ose profesional.

29. “Zotërues i fundit”, personi ose subjekti që zotëron një produkt gjatë fazës së përdorimit të ciklit të jetës së produktit, ose çdo person ose subjekt që vepron në emër të një personi ose subjekti të tillë.

3. Etiketa, dizajni/formati, përmbajtja e saj dhe vendi i vendosjes së etiketës

1. Furnizuesi siguron, për çdo llambë të parashikuar të tregtohet nëpërmjet një pike shitjeje, një etiketë të printuar, sipas formatit, dizajnit dhe informacionit të përcaktuar në pikën 1, të shtojcës I, që vendoset ose ngjitet në pjesën e jashtme të çdo ambalazhi individual, duke treguar jashtë etiketës fuqinë nominale të llambës së paketuar.



Furnizuesi siguron një etiketë elektronike në formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1, të shtojcës I, që është në dispozicion për shitje për çdo model llambe të vendosur në treg, me një identifikues të ri të modelit. Etiketa, gjithashtu, mund të jetë në dispozicion për shitje për modele të tjera të llambave.

Furnizuesit e ndriçuesve të parashikuar, që tregtojnë për përdoruesit fundorë, sigurojnë që:

a) nëse ndriçuesi është parashikuar të tregtohet në një pikë shitjeje, një etiketë e prodhuar në formatin dhe përmbajtjen e informacionit, siç përcaktohet në shtojcën I, vihet në dispozicion pa pagesë për tregtarët, në format elektronik apo letër. Nëse furnizuesi zgjedh një sistem të shpërndarjes, në të cilin etiketat jepen vetëm në bazë të kërkesës nga tregtarët, furnizuesi duhet të dorëzojë menjëherë etiketat, sipas një kërkesë;

b) nëse ndriçuesi është vendosur në treg në një paketim për përdoruesit fundorë, që përfshin llambat elektrike, të cilat përdoruesi fundor mund t'i zëvendësojë në ndriçues, paketimi origjinal i këtyre llambave përfshihet në paketimin e ndriçuesit;

c) një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1, të shtojcës I, të vihet në dispozicion për shitje për çdo model të vendosur në treg me një identifikues të ri të modelit. Ajo, gjithashtu, mund të jetë në dispozicion për shitje dhe për modele të tjera të llambave.

2. Tregtarët e ndriçuesve që tregtojnë për përdoruesit fundorë garantojnë që:

a) çdo model i ekspozuar në një pikë shitjeje shoqërohet me një etiketë, sipas përcaktimit në pikën 2, të shtojcës 1. Etiketa paraqitet në njërin nga mënyrat e mëposhtme ose me të dyja bashkë:

i) në afërsi të ndriçuesit të ekspozuar, qartësisht e dukshme dhe e identifikueshme që etiketa i përket modelit në fjalë, pa qenë e nevojshme të lexohet emri i markës dhe numri i modelit në etiketë;

ii) si shoqëruese e qartë e informacionit më të dukshëm për ndriçuesit e ekspozuar (si p.sh. informacione për çmimin ose informacione teknike) në pikën e shitjes.

b) nëse ndriçuesi shitet në një paketim për përdoruesin fundor që përfshin llamba elektrike, të cilat përdoruesi fundor mund t'i zëvendësojë në

ndriçues, paketimi origjinal i këtyre llambave përfshihet në paketimin e ndriçuesit;

c) çdo model i ofruar për shitje, qira ose blerje me këste nëpërmjet internetit, dhe për të cilin është një etiketë elektronike në dispozicion, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 3.1, shoqërohet nga një etiketë në përputhje me pikën 9.

4. Skeda informative për llambat elektrike

Furnizuesit e llambave elektrike, që i vendosin ato në treg si produkte më vete, sigurojnë që të vihet në dispozicion një skedë informative e produktit. Skeda informative përmban informacionin e specifikuar për etiketën. Në rastin kur nuk ka broshura të produktit, etiketa që shoqëron produktin mund të konsiderohet si skedë informative.

5. Dokumentacioni teknik

Furnizuesi siguron vënien në dispozicion të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), me kërkesë të këtij të fundit, dokumentacionin teknik, i cili përfshin:

a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që mundëson identifikimin e tij në mënyrë të qartë dhe të lehtë;

c) referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuar, sipas rastit;

ç) në rastin kur kërkohet, standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura;

d) identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të vepruar në emër të furnizuesit;

dh) parametrat teknike për përcaktimin e konsumit të energjisë dhe të efikasitetit të energjisë, në rastin e llambave elektrike, dhe të përputhshmërisë me llambat, në rastin e ndriçuesve, duke specifikuar, të paktën, një kombinim real të konfigurimeve të produktit dhe kushteve në të cilat testohet produkti;

e) për llambat elektrike, rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me pikën 6.4.

6. Standardet, metodat e matjes e të llogaritjeve si dhe niveli i saktësisë

Informacioni që jepet në pikën 3 sigurohet nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të matjeve, të cilat marrin parasysh metodat e njohura më të avancuara të matjes, të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2, të kësaj pike.

Gjatë kryerjes së kontrolleve, në kuadër të mbikëqyrjes të tregut, ISHMT informon ministrinë



përgjegjëse për tregtinë mbi rezultatet e këtyre kontrolleve.

ISHMT përdor procedura të besueshme, të sakta dhe të ripërsëritshme të matjeve, të cilat marrin parasysh metodat më bashkëkohore të matjes, të pranuar në përgjithësi, duke përfshirë metodat e përcaktuara në dokumente të referuara në fletoren zyrtare.

6.1. Procedura e verifikimit për llambat elektrike dhe modulet LED të tregtuara si produkte më vete

Për qëllime të kontrollit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 ISHMT-ja teston një mostër me të paktën 20 llamba nga i njëjti model dhe i njëjti prodhues, në rastin kur mundësohet, ato merren në proporcion të barabartë nga katër burime, të zgjedhura në mënyrë rastësore dhe duke marrë parasysh parametrat teknikë të përcaktuar në dokumentacionin teknik, sipas shkronjës “e”, në aneksin III.

Modeli konsiderohet se përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 3 nëse indeksi i efikasitetit të energjisë së modelit korrespondon me klasën e tij të deklaruar të efikasitetit të energjisë dhe nëse rezultatet mesatare të partisë nuk ndryshojnë më shumë se 10% nga vlerat limit të pragut ose të deklaruar (duke përfshirë indeksin e efikasitetit të energjisë).

Në të kundërt, modeli konsiderohet se nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 3.

Tabela 1

Klasa e efikasitetit të energjisë	Indeksi i efikasitetit të energjisë (EEI) për llambat jo drejtuese	Indeksi i efikasitetit të energjisë (EEI) për llambat drejtuese
A++ (më shumë efikente)	$EEI \leq 0,11$	$EEI \leq 0,13$
A+	$0,11 < EEI \leq 0,17$	$0,13 < EEI \leq 0,18$
A	$0,17 < EEI \leq 0,24$	$0,18 < EEI \leq 0,40$
B	$0,24 < EEI \leq 0,60$	$0,40 < EEI \leq 0,95$
C	$0,60 < EEI \leq 0,80$	$0,95 < EEI \leq 1,20$
D	$0,80 < EEI \leq 0,95$	$1,20 < EEI \leq 1,75$
E (më pak efikente)	$EEI > 0,95$	$EEI > 1,7$

Klasa e efikasitetit të energjisë të llambave përcaktohet në bazë të indeksit të tyre të efikasitetit të energjisë (EEI) sipas përcaktimit në tabelën 1.

EEI e llambave përcaktohet në përputhje me shtojcën VII.

6.4 Metoda për llogaritjen e indeksit të efikasitetit të energjisë dhe të konsumit të energjisë

1. Llogaritja e indeksit të efikasitetit të energjisë

Për llogaritjen e indeksit të efikasitetit të energjisë

Tolerancat për ndryshimin e përmendur më lart lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të matur nga ana e ISHMT-së dhe nuk duhet të përdoret nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për vlerat e paraqitura në dokumentacionin teknik për të arritur një klasë më të mirë të efikasitetit të energjisë.

Vlerat e deklaruar nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik.

6.2 Procedurat e verifikimit për ndriçuesit që tregtohen ose parashikohen të tregtohen te përdoruesi fundor

Ndriçuesit konsiderohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 dhe nëse shoqërohen me informacionin e kërkuar për produktin dhe nëse rezulton se janë në përputhje me të gjitha llambat, me të cilat është deklaruar në përputhje me pikën 2.2 IV (a) dhe (b) të shtojcës I, duke përdorur metodat dhe kriteret më të avancuara sipas zhvillimit teknologjik për vlerësimin e përputhshmërisë.

6.3 Klasat e efikasitetit të energjisë

Klasa e efikasitetit të energjisë të llambave përcaktohet në bazë të indeksit të tyre të efikasitetit të energjisë (EEI), sipas përcaktimit në tabelën 1.

EEI e llambave përcaktohet në përputhje me pikën 6.4.

(EEI) të një modeli bëhet krahasimi i fuqisë së tij, i korrigjuar për çdo humbje të mundshme të njësisë së kontrollit, me fuqinë e tij të referencës. Fuqia e referencës nxirret nga fluksi i dobishëm i dritës, i cili i korrespondon fluksit të përgjithshëm për llambat jodrejtuese, dhe me fluksin në një kon me 90° ose 120°, për llambat drejtuese.

EEI llogaritet me formulën e mëposhtme dhe rrumbullakoset në dy shifra dhjetore:

$$EEI = P_{nom}/P_{ref}$$



ku:

P_{nom} është fuqia nominale (P_{nom}) për modele pa njësi të jashtme kontrolli dhe fuqia nominale e korigjuar (P_{rat}), në përputhje me

tabelën 2, për modele me njësi të jashtme kontrolli. Fuqia nominale e llambave matet në tensionin e tyre nominal të hyrjes.

Tabela 2

Korrigjimi i fuqisë nëse modeli komandohet me njësi të jashtme kontrolli

Fusha e zbatimit e korrigjimit	Fuqia e korigjuar për humbjet nga njësia e kontrollit (P_{nom})
Llambat që komandohen me njësi të jashtme kontrolli për llamba halogjene	$P_{nom} \times 1,06$
Llambat që komandohen me pajisje të jashtme kontrolli për llambat LED	$P_{nom} \times 1,10$
Llambat fluoreshente me diametër 16 mm (llambat T5) dhe llambat fluoreshente me xokol me 4 kunjë që komandohen me pajisje të jashtme kontrolli për llamba fluoreshente.	$P_{nom} \times 1,10$
Llamba të tjera që komandohen me pajisje të jashtme kontrolli për llamba fluoreshente	$P_{nom} = \frac{\sqrt{\Phi_{përd} + 0.0103\Phi_{për}}}{\sqrt{\Phi_{përd} + 0.097\Phi_{për}}}$
Llamba që komandohen me njësi të jashtme kontrolli për llamba me shkarkesë në gaz me intensitet të lartë	$P_{nom} \times 1,10$
Llamba që komandohen me njësi të jashtme kontrolli, për llamba me avull natriumi me presion të ulët.	$P_{nom} \times 1,15$

P_{ref} është fuqia reference e nxjerrë nga fluksi i dobishëm i dritës për modelin ($\Phi_{përd}$) nëpërmjet formulave të mëposhtme:

Për modele me $\Phi_{përd} < 1\,300$ lumen:

$$P_{ref} = 0,88\sqrt{\Phi_{për}} + 0,049\Phi_{për}$$

Tabela 3

Përcaktimi i fluksit ndriçues të dobishëm

Për modele me $\Phi_{përd} \geq 1300$ lumen:

$$P_{ref} = 0,07341\Phi_{për}$$

Fluksi i dobishëm i dritës ($\Phi_{për}$) përcaktohet në përputhje me Tabelën 3.

Modeli	Fluksi i dobishëm i dritës ($\Phi_{përd}$)
Llambë jo drejtuese Llambë drejtuese me një kënd tufe $\geq 90^\circ$ të ndryshme nga llambat me filament në ambalazhin e të cilave gjendet një paralajmërim në formë teksti ose grafike që tregon se ato nuk janë të përshtatshme për ndriçim të theksuar.	Fluksi total nominal i dritës (Φ) Fluksi nominal i dritës në një kon 120° (Φ_{120°)
Llamba të tjera drejtuese	Fluksi nominal i dritës në një kon (Φ_{90°)

2. Llogaritja e konsumit të energjisë

Konsumi i ponderuar i energjisë (E_c) llogaritet në kWh orë nëpërmjet formulës së mëposhtme dhe rrumbullakoset në dy shifra dhjetore:

$$E_c = \frac{P_{cor} \times 1000 \text{ orë}}{1000}$$

Ku P_{kor} është fuqia e korigjuar për humbjet e mundshme nga pajisja e kontrollit, në përputhje me paragrafin 1.1 të mësipërm.

7. Informacioni që duhet dhënë në rastet kur zotëruesi i fundit nuk ka mundësinë të shikojë produktin e ekspozuar

1. Informacioni i lidhur me çdo model të ofruar për shitje, dhënie me qira ose shitje me



këste, në situata në të cilat nuk pritet që pronari i fundit të shikojë produktin e ekspozuar, tregtohet me informacionin që duhet siguruar nga furnizuesi, si më poshtë vijon:

a) klasa e efikasitetit të energjisë, e përcaktuar në pikën 6.3;

b) në rastin kur kërkohet në shtojcën I, konsumi i ponderuar i energjisë në kWh për 1000 orë, i rrumbullakosur në shifrën e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të pikës 6.4.

2. Çdo informacion tjetër i dhënë në skedën informative të produktit jepet në formën dhe rendin e specifikuar në pikën 4.

3. Madhësia dhe lloji i fondit në të cilin printohet ose paraqitet i gjithë informacioni i dhënë në këtë pikë duhet të jetë i lexueshëm

8. Përmbajtja specifike e etiketës në rastin e publiciteteve

1. Furnizuesit e llambave elektrike që i vendosin në treg si produkte më vete, sigurojnë që:

a) çdo publicitet, ofertë zyrtare çmimi ose ofertë tenderi që jep informacion në lidhje me ndikimin e energjinë ose çmimin për një llambë specifike, të tregojë klasën e efikasitetit të energjisë;

b) çdo material publiciteti teknik për një llambë specifike, i cili përshkruan parametrat teknike specifike të saj, të tregojë klasën e efikasitetit të energjisë.

2. Tregtarët e llambave elektrike sigurojnë që;

a) çdo model i ofruar për shitje, dhënie me qira ose shitje me këste, në situata në të cilat nuk pritet që pronari i fundit të shikojë produktin e ekspozuar, tregtohet me informacionin që sigurohet nga furnizuesi në përputhje me pikën 7.

b) të tregojnë klasën e efikasitetit të energjisë në çdo publicitet, ofertë zyrtare çmimi ose ofertë tenderi që jep informacion lidhur me ndikimin në energjinë ose çmimin për një model specifik;

c) çdo material publiciteti teknik për një model specifik, i cili përshkruan parametrat teknike specifike të tij, të tregojë klasën e efikasitetit të energjisë të modelit.

3. Tregtarët dhe furnizuesit e ndriçueseve që tregtojnë për përdoruesit fundorë garantojnë që informacioni i përmbajtur në etiketë, në përputhje me pikën 2, në shtojcën I, të jepet për

situatat e mëposhtme:

a) në çdo publicitet, ofertë zyrtare çmimi ose ofertë tenderi që jep informacion për ndikimin në energji ose çmimin për një ndriçues të veçantë;

b) në çdo material publiciteti teknik për një ndriçues specifik i cili përshkruan parametrat teknike specifike të tij;

Në këto raste informacioni mund të paraqitet në formate të ndryshme nga formati i përcaktuar në pikën 2, në shtojcën I, p.sh. në format vetëm me tekst;

9. Informacioni që duhet të ofrohet në rast të shitjes në distancë ose blerjeje me këste, nëpërmjet internetit

1. Për qëllime të pikave nga 2 deri më 5, të kësaj pike, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Mekanizëm ekran”, çdo ekran, duke përfshirë edhe ekranin e prekshëm ose teknologji të tjera vizuale, të përdorura për të shfaqur përmbajtjen e internetit për përdoruesit;

b) “Ekran i mbivendosur”, një ndërfaqe vizuale, në rastin kur një imazh apo grup të dhënash arrihet nga një klik i mausit mbi ose në ekran të prekshëm të zgjerimit të një imazhi apo grup të dhënash të vendosura;

c) “Ekran i prekshëm”, një ekran që i përgjigjet prekjes, të tilla si ajo e një kompjuteri tabletë, kompjuter ose një *smartphon*-i;

ç) “Tekst alternativ”, teksti i dhënë si një alternativë për një informacion të një grafike të lejuar për t'u paraqitur në formë jo grafike, në rastin kur pajisjet e ekranit nuk mund të bëjnë grafikë ose të ndihmojnë për qasje të tilla, si të dhëna që shprehin aplikime sintezë.

2. Etiketa përkatëse, e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 3(d), të kësaj shtojce, tregohet në mekanizmin e ekranit me çmimin e produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë e qartë, e dukshme dhe e lexueshme si dhe në proporcion me madhësinë e përcaktuar në pikën 2, të shtojcës I. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të mbivendosur, në këtë rast imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë duhet të jetë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në paragrafin 3, të kësaj shtojce. Nëse zbatohet ekranin i mbivendosur, etiketa të shfaqet në klikun e parë të mausit ose në ekranin e prekshëm në zgjerimin e imazhit.

3. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë, në rastin e ekranit të mbivendosur;

a) është një shigjetë në ngjyrën që i korrespondon klasës së efijensës së energjisë të produktit mbi etiketë;

b) tregon në shigjetë klasën e efijencës së energjisë të produktit në të bardhë, në një madhësi fonti të njëvlerëshme me atë të çmimit;

c) ka një nga dy formatet e mëposhtme:



4. Në rastin e ekranit me mbivendosje, sekuenca e ekranit të etiketës është si më poshtë:

a) Imazhi i përmendur në pikën 3, të kësaj shtojce, tregohet në mekanizmin e ekranit në afërsi me çmimin e produktit;

b) mazhi duhet të lidhet me etiketën;

c) etiketa duhet të shfaqet pas një klikimi të mausit ose me zgjerimin e imazhin në ekranin e prekshëm;

ç) etiketa duhet të shfaqet nga *pop up*, skedë e re, faqe e re apo ekran inaktiv.

d) për zmadhim të etiketës në ekranin me prekje zbatohen konventat e pajisjes për zmadhim me prekje;

dh) etiketa ndalon si shfaqje me anë të një opsioni të afërt ose mekanizmi tjetër për mbyllje

standarde;

e) teksti alternativ për grafikën që do të shfaqet, kur nuk shfaqet etiketa, është klasa e efijensës së energjisë e produktit, në një madhësi fonti të njëvlerëshme me atë të çmimit.

5. Skeda informative përkatëse e produktit, e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 3(e), të kësaj shtojce, tregohet në mekanizmin e ekranit në afërsi me çmimin e produktit. Madhësia është e tillë që skeda e produktit të jetë e qartë, e dukshme dhe e lexueshme. Skeda e produktit mund të shfaqet duke përdorur një mbivendosje në ekran, në rastin kur linku i përdorur për të hyrë në skedë të jetë i qartë dhe lexueshëm dhe të tregojë “Skeda e produktit”. Nëse përdoret mbivendosja në ekran, skeda e produktit shfaqet në klikun e parë të mausit ose në ekranin e prekshëm me zgjerim të linkut.

Shtojca I

Etiketat

1. Etiketa për llambat elektrike të ekspozuara në një pikë shitje

(1). Etiketa është sipas ilustrimit të mëposhtëm, nëse nuk është e printuar në ambalazh:



(2) Në etiketë shënohet informacioni i mëposhtëm:

- i) Emri ose marka tregtare e furnizuesit;
- ii) Identifikuesi i modelit të furnizuesit, që nënkupton kodin, zakonisht alfanumerik, që dallon një model specifik llambe nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit;
- iii) Klasa e efijencës së energjisë, e përcaktuar në përputhje me aneksin VI, maja e shigjetës tregon klasën e efijencës së energjisë së llambës vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës që tregon klasën përkatëse të efijencës


së energjisë;

iv) Konsumi i ponderuar i energjisë (EC) në kWhorë për 1000 orë, i llogaritur dhe rrumbullakosur në shifrën e plotë më të afërt në përputhje me aneksin VII.

(3) Nëse etiketa është e printuar mbi ambalazh dhe informacioni i specifikuar në paragrafin 2 (i), (ii) dhe (iv) paraqitet diku tjetër në ambalazh, nuk është e nevojshme që ky informacion të paraqitet në etiketë. Në këtë rast etiketa të zgjidhet sipas ilustrimeve të mëposhtëm:



(4) Modeli i etiketës është si më poshtë:



ku:

a) specifikimet e përmasave në figurën e mësipërme dhe në shkronjën ç) të kësaj nënpike zbatohen në një etiketë llambe me gjerësi 36 mm dhe lartësi 75 mm. Nëse etiketa është printuar në një format të ndryshëm, përmbajtja e saj të mbetet gjithsesi në përpjesëtim me specifikimet e mësipërme.

Versioni i etiketës i specifikuar në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të kësaj shtojce të jetë, të paktën, 36 mm i gjerë dhe 75 mm i lartë, dhe versionet e specifikuara në nënpikën 1.3 të jenë, përkatësisht të paktën 36 mm i gjerë dhe 68 mm të larta dhe të paktën 36 mm të gjera dhe 62 mm të larta.

Nëse asnjë faqe e ambalazhit nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për të përfshirë brenda saj etiketën dhe pjesën anësore të saj, ose nëse ajo mbulon më shumë se 50% të sipërfaqes së faqes më të madhe, etiketa dhe pjesa anësore e saj mund të zvogëlohen, por jo më shumë sa është e nevojshme për të përmbushur të dyja këto

kushte. Megjithatë, etiketa dhe pjesa anësore e saj nuk mund të zvogëlohen më pak se 40% (sipas lartësisë) të madhësisë standarde të saj. Nëse ambalazhi është tepër i vogël për të vendosur një etiketë të tillë të zvogëluar, një etikete me gjerësi 36 mm dhe lartësi 75 mm ngjitet në llambë ose në ambalazh.

b) Sfondi është i bardhë për të dy versionet shumëngjyrëshe, ashtu dhe për versionet njëngjyrëshe të etiketës;

c) për versionin shumëngjyrësh të etiketës, ngjyrat janë CMYK - e kaltër, e kuqe, verdhë dhe e zezë, sipas shembullit: 00-70-X-00: 0% e kaltër, 70% e kuqe, 100% e verdhë, 0% e zezë;

ç) etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më lart, specifikimet e ngjyrës vlejnë vetëm për versionin shumëngjyrësh të etiketës):

1 Korniza e jashtme: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 1 mm

2 Logo BE: ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

3 Logo e energjisë: ngjyra: X-00-00-00.
Piktograma si tregohet: logo EU dhe logo e energjisë (të kombinuara): gjerësia: 30 mm, lartësia: 9 mm.

4 Vija ndarëse poshtë logove: 1 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, gjatësia: 30 mm.

5 Shkalla A++-E
— **Shigjeta:** lartësia: 5 mm, hapësira: 0,8 mm, ngjyrat:

— Klasa më e lartë: X-00-X-00,

— Klasa e dytë: 70-00-X-00,

— Klasa e tretë: 30-00-X-00,

— Klasa e katërt: 00-00-X-00,

— Klasa e pestë: 00-30-X-00,

— Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,

— Klasa e fundit: 00-X-X-00.

— **Teksti:** Kalibri bold 15 pt, shkronja kapitale dhe të bardha; simbolet '+': Kalibri bold 15 pt, Indeksi i sipërm, i bardhë, renditur në një rresht të vetëm.

6 Klasa e efijencës së energjisë
— **Shigjeta:** gjatësia: 11.2 mm, lartësia: 7 mm, 100 % e zezë.

— **Teksti:** Kalibri bold 20 pt, kapitale dhe të

bardha; simbolet '+': Kalibri bold 20 pt, Indeksi i sipërm, i bardhë, renditur në një rresht të vetëm.

7 Vlera e konsumit të ponderuar të energjisë

— **Vlera** Kalibri bold 16 pt, 100 % e zeze; dhe e rregullt 9 pt, 100 % e zezë.

8 Emri ose marka tregtare e furnizuesit

9 Identifikuesi i modelit të furnizuesit


10 Emri ose marka tregtare e furnizuesit dhe identifikuesi i modelit duhet të shënohet brenda një hapësirë 30 × 7 mm.

Asnjë element tjetër i vendosur, i printuar ose i ngjitur mbi ambalazhin individual nuk duhet të mbulojë etiketën ose të zvogëlojë dukshmërinë e saj.

Me anë të derogimit, nëse një model ka marrë etiketën ekologjike, mund të shtohet një kopje e kësaj etikete në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Etiketa për ndriçuesit e ekspozuar në një pikë shitjeje

(1) Etiketa është në versionin shqip ose anglisht dhe paraqitet sipas ilustrimit të mëposhtëm, ose si në variantet e përcaktuar në paragrafët (2) dhe (3) të kësaj pike:



I
II
III
IV
V

(2) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

i) Emri ose marka tregtare e furnizuesit;

ii) Identifikuesi i modelit të furnizuesit, d.m.th. kodi, zakonisht alfanumerik, që dallon një model specifik ndriçuesi nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit;

iii) Fjalë që tregohet në shembullin e nënpikës 2.1 të kësaj Shtojce ose sipas rastit, një nga alternativat e saj nga shembujt në nënpikën e mëposhtme (3). Në vend të fjalës 'ndriçues', mund të përdoret një term më specifik që përshkruan tipin e veçantë të ndriçuesit ose produktin në të cilin është i integruar ndriçuesi (p.sh. një mobilie), me kusht që të jetë e qartë se termi i referohet produktit në shitje që përdor burimet e dritës;

iv) Gama e klasave të efikasitetit të energjisë, sipas pikës 1 të kësaj Shtojce, e shoqëruar, sipas rastit, me elementët e mëposhtëm:

a) një piktogram të një "poçi" ku tregohen klasat e llambave që mund të ndërrohen nga përdoruesi dhe që janë në përputhje me ndriçuesin sipas kërkesave të zhvillimit teknik për përputhshmërinë;

b) një kryq të vendosur mbi klasat e llambave me të cilat ndriçuesi nuk përputhet sipas kërkesave të zhvillimit teknik për përputhshmërinë;

c) gjerat "LED" të renditura vertikalisht përbri klasave nga A në A++ nëse ndriçuesi përmban module LED që nuk parashikohen të hiqen nga përdoruesi fundor. Nëse një ndriçues i tillë nuk ka portollamba për llamba që mund të ndërrohen nga përdoruesi, mbi klasat nga B deri më E vendoset një kryq.

v. sipas rastit, një nga opsionet e mëposhtme:

a) nëse ndriçuesi funksionon me llamba që

mund të ndërrohen nga përdoruesi fundor dhe këto llamba përfshihen në ambalazhin e ndriçuesit, fjalë siç tregohet në shembullin e dhënë në paragrafin (1), duke shënuar klasën përkatëse të energjisë.

Nëse është e nevojshme, fjalë mund të përshtatet që t'i referohet një ose disa llambave dhe mund të renditen disa klasa të energjisë;

b) nëse ndriçuesi përmban vetëm module LED që nuk parashikohen të hiqet nga përdoruesi fundor, fjalë tregohet në shembullin në germën "b" të paragrafit.(3)


të kësaj pike;

c) nëse ndriçuesi përmban edhe module LED që nuk parashikohen të hiqet nga përdoruesi fundor dhe portollamba për llamba të ndërrueshme dhe këto llamba nuk përfshihen me ndriçuesin, fjalë tregohet në shembullin në germën ç) të paragrafit (3) të kësaj shtojce;


ç) nëse ndriçuesi punon vetëm me llamba që mund të ndërrohen nga përdoruesi fundor dhe këto llamba nuk përfshihen me ndriçuesin, hapësira lihet bosh, siç tregohet në shembullin në germën a) të paragrafit (3) të kësaj pike.

(3) Ilustrimet e mëposhtme japin shembuj të etiketave tipike për ndriçuesit, përveç ilustrimit paragrafin (1) të kësaj pike pa treguar të gjitha kombinimet e mundshme:


a) ndriçues që punon me llamba të ndërrueshme dhe i përputhshëm me llamba të të gjitha klasave të energjisë por në rastin kur llambat nuk përfshihen:




b) ndriçues që përmban vetëm module LED të pandërrueshëm.




c) ndriçues që përmban edhe module LED të pandërrueshëm dhe portollamba për llamba të ndërrueshme dhe që përfshin edhe llambat:



ç) ndriçues që përmban edhe module LED të pandërrueshëm dhe portollamba për llamba të ndërrueshme, por ku llambat nuk përfshihen:



(4) Modeli i etiketës është si në figurat e mëposhtme:



a) versioni i etiketës është të paktën 50 mm i gjerë dhe 100 mm i lartë;

b) sfondi është i bardhë ose transparent, por shkronjat e klasave të energjisë janë gjithmonë të bardha. Nëse sfondi është transparent, tregtari garanton që etiketa vendoset mbi një sipërfaqe të bardhë ose gri të hapur që ruan lexueshmërinë e të gjithë elementeve të etiketës;

c) ngjyrat janë CMYK – e kaltër, e kuqe, e verdhë dhe e zezë, sipas shembullit: 00-70-X-00: Faqe|26578

0 % e kaltër, 70% e kuqe, 100% e verdhë, 0% e zezë;

ç) etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më lart):

1 Korniza e jashtme: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 1 mm

2 Kufiri i nenlogove: 1 pt – ngjyra e kaltër 100 % - gjatësia 43 mm;



3 Logo e ndriçuesit: korniza 1 pt – ngjyra e kaltër 100 %

Madhësia 13 mm x 13 mm, rakordimet në kënde 1 mm. Piktograma si tregohet, ose piktograma e vetë furnizuesit ose foto, nëse përshkruan më mirë ndriçuesin përkatës të etiketës.

4 Teksti: Kalibër i rregullt 9 pt ose më i gjerë, 100% e zezë.

5 Shkalla A++-E

— **Shigjeta:** lartësia: 5 mm, hapësira: 0,8 mm, ngjyrat:

- Klasa më e lartë: X-00-X-00,
- Klasa e dytë: 70-00-X-00,
- Klasa e tretë: 30-00-X-00,
- Klasa e katërt: 00-00-X-00,
- Klasa e pestë: 00-30-X-00,
- Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
- Klasa e fundit: 00-X-X-00.

— **Teksti:** Kalibri bold 14 pt, shkronja kapitale dhe të bardha; simbolet '+': Kalibri bold 14 pt, Indeksi, i bardhë, renditur në një rresht të vetëm.

6 Teksti LED: Verdana normal 15 pt, 100 % e zezë;

7 Kryqi: ngjyra: 13-X-X-04, korniza 3 pt.

8 Logo e Llambës: Piktograma si tregohet

9 Teksti: Kalibër i rregullt 10 pt ose më e gjerë, 100% e zezë.

10 Numri i Rregullores: Kalibri bold 10 pt, 100% e zezë.

11 Logo BE: Ngjyrat X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

12 Emri ose marka tregtare e furnizuesit

13 Identifikuesi i modelit të furnizuesit:

Emri ose marka tregtare e furnizuesit dhe identifikuesi i modelit shënohen brenda një hapësirë me përmasa 43 × 10 mm.



14 Shigjeta e klasës së energjisë:

Shigjeta lartësia 3.9 mm, Gjerësia: siç tregohet në ilustrim në paragrafin (4), por e zvogëluar në raport të njëjtë me lartësinë, ngjyra: ngjyra e përcaktuar në nënpikë, si e zbatuar.

— **Teksti: Kalibri bold 10.5 pt, kapitale dhe të bardha; simbolet '+':** Kalibri bold 10.5 pt, Indeksi, i bardhë, renditur në një rresht të vetëm.

Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të shënuar shigjetat e klasës së energjisë brenda hapësirës së fjalisë të përmendur në germën a) të paragrafit (2)(V), mund të përdoret për këtë qëllim hapësira ndërmjet numrit të Rregullores dhe logos EU.

d) etiketa mund të paraqitet edhe në drejtim horizontal, në këtë rast ajo të jetë në gjerësi të paktën 100 mm dhe në lartësi 50 mm. Komponentët e etiketës janë sipas përshkrimit si në germat nga b) deri në ç) dhe renditen, sipas rastit, në përputhje me shembujt e mëposhtëm. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të paraqitur shigjetat e klasës së energjisë në kutinë e tekstit, në të majtë të shkallës A + + deri në E, kutia e tekstit mund të zgjerohet vertikalisht sa të jetë e nevojshme.

**VENDIM**

Nr. 944, datë 28.12.2016

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT DHE
TË BUXHETIT TË VITIT 2017 PËR
ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, dhe 22, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të nenit 29, të ligjit nr.9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2017, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Miratimin e buxhetit për programin e Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2017, sipas shtojcave 2 dhe 3, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1

PEMA E PROGRAMIT TE ZRPP PER VITIN 2017

Qëllimi i Politikës së Programit


Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepërmjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditësimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVI 1: Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme dhe Përmirësimi i të dhënave

OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

OBJEKTIVI 3: Ndërtimi i infrastruktures së ZRPP nrm kompletimit të zrrp me pajisje elektronike, orëdi, dhe rikonstrukcionit të ambjenteve të ZRPP





SHTOJCA 2

Në 000/ lekë

BUXHETI 2017

Përshkrimi	Buxheti 2017	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	2,160,315	
Shpenzime personeli		819,228
Shpenzime korente		300,394
Investime		935,993
Fondi rezervë		104,700
Total	2,160,315	2,160,315
Teprica (1)-(2)		0

BUXHETI I VITIT 2017
SHTOJCA 3

Në 000/ lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2017
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	2,160,315
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,580,000
	Fonde që parashikohet të trashëgohen nga viti 2016	475,615
	Fond rezervë i trashëguar	104,700
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	2,160,315
1	Shpenzime personeli	819,228
	Paga	676,957
	Kontribute për sigurime shoqërore	112,331
	Fondi i veçantë i pagave	29,940
2	Shpenzime operative	300,394
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	200,640
3	Shpenzime kapitale	935,993
	Investime kapitale të brendshme	627,993
	Fonde të lira në dispozicion të përmirësimit përditësimit; regjistrimit fillestar dhe dixhitalizimit të të dhënave të pasurive të paluajtshme	308,000
4	Fondi Rezervë	104,700
	Fondi Rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0

VENDIM

Nr. 945, datë 28.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR.408, DATË 8.5.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DËMSPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E
ELIMINUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin, emërtimi “drejtoria rajonale e bujqësisë në qark (DRB)” zëvendësohet me emërtimin “drejtoria e bujqësisë (DB)”;

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Pronarët e kafshëve, të cilat kanë ngordhur si pasojë e prekjes nga sëmundja e Dermatizës Nodulare të Gjedisit, dëmshpërblehen fizikisht me kafshë, sipas pikës 13, të këtij vendimi”.

3. Në pikën 2, fjalia e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Janë subjekt dëmshpërblimi sipas pikave 1



dhe 1.1, të këtij vendimi, vetëm pronarët e kafshëve, të cilat:”.

4. Në pikën 4, fjalët “...një përfaqësues i shërbimit veterinar të njësisë së qeverisjes vendore...” zëvendësohen me “...një përfaqësues i qeverisjes vendore...”.

5. Në pikën 7, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, si më poshtë vijon:

“d) menjëherë, pas konfirmimit zyrtar, në rastin e sëmundjes së Dermatozës Nodulare të Gjedhit.”.

6. Në fund të pikës 9 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Ky komision kryen edhe vlerësimin e dokumentacionit në rastin e dëmshpërblimit fizikisht me kafshë.”.

7. Në pikën 11, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “...ose procesverbalin e dëmshpërblimit fizik në kafshë...”.

8. Në fund të pikës 13 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Dëmshpërblimi fizik me kafshë do të bëhet në përputhje me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.”.

9. Pika 14 riformulohet, si më poshtë vijon:

“14. Titullari i DB-së nxjerr aktin për dëmshpërblimin e pronarit të kafshës, i cili duhet të zbatohet nga DB-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dalja e aktit të dëmshpërblimit, me përjashtim të rastit kur dëmshpërblimi bëhet fizik, me kafshë, për të cilat ndiqen procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.”.

10. Pika 17 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“17. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 948, datë 28.12.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “LEVAN-TEPELENË (SHTESA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë (shtesa)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall”, “pyll” dhe “drurë frutorë”, në vlerën prej 4 375 756 (katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) për “arë”, me sipërfaqe 11018 (njëmbëdhjetë mijë e tetëmbëdhjetë) m², vlerë 1 234 016 (një milion e dyqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë;

b) për “truall”, me sipërfaqe 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², me vlerë 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) lekë.

c) për “pyll”, me sipërfaqe 21 638 (njëzete një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) m², me vlerë 2 163 800 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë;

ç) për “drurë frutorë”, me vlerë 938 940 (nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall”, “pyll” dhe “drurë frutorë”, prej 4 375 756 (katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga



fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga

Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor "Levan-Tepelenë (shtesa)"

Fshatrat: Iliras dhe Qesarat

	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.Pas	Sip. Total e	Sip.shpr . Arë (m2)	Sip.Shpr. Pyll (m2)	Sip.shp . Truall (m2)	Cmi mi	Vlera (lekë) drufrutorë dhe kult. bujqësore	Vlera	Shenime
1	Xhelil	Behl	Muka	3111	14/6	2200	1115			112		124880	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Myslym		Lika	3111	14/22	2475	1278			112		143136	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Shyqo	Hysen	Zeqaj	3111	37/1	1030	56			112		6272	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Dashamir	Veip	Kasa	3111	51/11	584	182			112		20384	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Axhem	Jazo	Meta	3111	145/1	500			142	125		17750	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Reit	Yzeir	Zeqaj	3111	145/2	1100	490			112		54880	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Reit	Yzeir	Zeqaj	3111	145/4	500	143			112		16016	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Shefqet	Gani	Sina	3111	145/5	1000	343			112		38416	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Agim	Reit	Zeqaj	3111	145/3	500	205			112		22960	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Gezim	Shaban	Shehu	3111	145/6	1500	642			112		71904	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Qazim	Velisha	Velika	3111	145/8	700	309			112		34608	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Bashkim	Hajri	Alicani	3111	145/9	700	315			112		35280	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Petrit	Jazo	Meta	3111	145/10	800	230			112		25760	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Qemal	Jaho	Jaupi	3111	145/25	550	3			112		336	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Halim		Mema	3111	145/11	500	158			112		17696	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Xhelil	Behl	Mukaj	3111	145/12	450	119			112		13328	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Dalip	Shyqo	Meta	3111	145/13	1000	291			112		32592	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Shefit	Shyqo	Meta	3111	145/14	500	164			112		18368	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Halim	Sulo	Mema	3111	145/15	400	270			112		30240	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Sulo	Mehmet	Meta	3111	145/16	1100	368			112		41216	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Veli	Yzeir	Zeqaj	3111	145/24	1100	279			112		31248	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Hysen	Muharrem	Zeqaj	3111	145/18	2200	712			112		79744	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Reit		Zeqaj	3111	14/23	2250	1131			112		126672	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Arif	Xhaferr	Lalaj	1980	153/4	7600	784			112		87808	Konfirmuar nga ZVRPP
25	Shahin		Hoda	1980	82	2200	323			112		36176	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Ibrahim,Defrim Veizaj			1980	175/2	232600		21638		100		2163800	Konfirmuar nga ZVRPP
27	Arif	Xhaferr	Lala	1980	186/4	300			13	125		1625	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Demir	Male	Goga	1980	189/48	1900	10			112		1120	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Eduart	Zano	Kalemi	1980	189/50	1300	30			112		3360	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Reit	Haki	Kalemi	1980	189/52	1400	21			112		2352	Konfirmuar nga ZVRPP



31	Metush	Haki	Kalemi	1980	189/53	1500	47			112		5264	Konfirmuar nga ZVRPP
32	Reshat	Haki	Kalemi	1980	189/54	800	64			112		7168	Konfirmuar nga ZVRPP
33	Zini	Zeço	Kamberi	1980	189/57	1000	50			112		5600	Konfirmuar nga ZVRPP
34	Bashkepronesi			1980	189/100	2000	92			112		10304	Konfirmuar nga ZVRPP
35	Engjell	Qerim	Kamberi	1980	189/60	700	51			112		5712	Konfirmuar nga ZVRPP
36	Bashkepronesi		Manaj	1980	189/61	1800	70			112		7840	Konfirmuar nga ZVRPP
37	Alush	Feta	Kamberi	1980	189/64	1000	16			112		1792	Konfirmuar nga ZVRPP
38	Agim	Nuri	Kamberi	1980	189/76	1000	70			112		7840	Konfirmuar nga ZVRPP
39	Rabian,Bako	Meto	Hysotoci	1980	206/47	300			157	125		19625	Konfirmuar nga ZVRPP
40	Xhemal	Feta	Kamberi	1980	214/32	600	106			112		11872	Konfirmuar nga ZVRPP
41	Qemal	Demir	Goga	1980	214/28	1000	41			112		4592	Konfirmuar nga ZVRPP
42	Bashkim		Lolaj	1980	214/47	1000	23			112		2576	Konfirmuar nga ZVRPP
43	Myzafer		Lolaj	1980	214/26	700	30			112		3360	Konfirmuar nga ZVRPP
44	Shuap		Lolaj	1980	214/25	800	34			112		3808	Konfirmuar nga ZVRPP
45	Muharrem		Lolaj	1980	214/24	800	39			112		4368	Konfirmuar nga ZVRPP
46	Zini	Shaqo	Kamberi	1980	214/22	300	34			112		3808	Konfirmuar nga ZVRPP
47	Bashkepronesi			1980	214/46	1600	45			112		5040	Konfirmuar nga ZVRPP
48	Belul		Caushi	1980	214/33	600	72			112		8064	Konfirmuar nga ZVRPP
49	Rexhep	Bektash	Kamberi	1980	214/1	2000	2			112		224	Konfirmuar nga ZVRPP
50	Bashkim		Velikaj	1980	217/9	1120	161			112		18032	Konfirmuar nga ZVRPP
51	Agim	Reit	Zeçaj	1980	150,153/5						938940	938940	Konf. nga ZVRPP për token me qira 99 vjet
TOTALI							11018	21638	312			4375756	

VENDIM**Nr. 949, datë 28.12.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA
LINDORE SHKODËR DHE UNAZA
SHKODËR-RUS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Shkodër dhe Unaza Shkodër-Rus”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “objekte”, në vlerën prej 33 805 453 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, nga të cilat:

a) për “truall”, me sipërfaqe 2 001.4 (dy mijë e një pikë katër) m², me vlerë 20 630 843 (njëzet

milione e gjashtëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë;

b) për “objekte”, me vlerë 13 174 610 (trembëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “truall” dhe “objekte”, prej 33 805 453 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në



dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti

Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Këshilli i Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që pronat e tyre preken nga ndërtimi i segmenteve rrugore “Unaza Lindore Shkodër” dhe “Shkodër- Rus” (Truall)

Lista Nr.1

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kad.	Numri Pas.	Lloji Pas.	Sipërf. Përgjith. m2	Sip.e Shpron. (m2)	Çmimi lekë/m2	Vlera, Leke	Shënime
1	Qemal	Hamza	Suma	8597	10/162	Truall	300	124	8511	1055364	Konfirmuar
2	Ferid,	Eqerem, Sadete	Paçrami	8597	7,/61	Truall	400	70.7	8511	601728	Konfirmuar
3	Safet, Sabahet Satber		Kopliku	8594	9/251	Truall	445	90	12223	1100070	Rikonfirm ZVRPP
4	Ardian Suzana	Lec Qamil	Kallmeti Kallmeti	8594	9/172	Truall	600	209	12223	2554607	Proces regjistrimi
5	Frano		Shqau	8594	9/337	Truall	575.8	105	12223	1283415	Rikonfirm ZVRPP
6	Afërdita Marstela Aferjona Endri		Lohja Lohja Lohja Lohja	8594	11/209	Truall	1355	118	12223	1442314	Rikonfirm ZVRPP
7	Vitote,Gjergj,	Aleksandër	Leqejeza	8594	15/376	Truall	2600	46	12223	562258	Konfirmuar
8	Paulin		Radovani	8593	8/294	Truall	5648	119	8511	1012809	Konfirmuar
9		Adelchi Shqipëria Sh.p.k		8593	10/482	Truall	5648	95	8511	808545	Konfirmuar
10	Tonin	Martin	Shqau	8593	10/191	Truall	300	198	8511	1685178	Rikonfirmim
11	Trashëgimtarët		Muzhani	8593	12/83,	Truall	1450	188	8511	1600068	Konfirmuar
12	Marin	Ded	Majnishta	8593	13/534	Truall	1002.5	10	8511	85110	Konfirmuar
13	Pjerin	Gjon	Verri	8593	12/394	Truall	251.3	35.7	8511	303843	Proces Regjistrimi
14	Tom	Lulash	Ndërshtigaj	8593	12/101	Truall	300	60	8511	510660	Proces Regjistrimi
15	Zoje		Gjeka	8592	8/638	Truall	300	61	12223	745603	Konfirmuar
16	Lulzim	Çun	Dedaj	8592	8/640	Truall	186.6	113	12223	1381199	Konfirmuar
17	Tonin	Mhill	Buxhaj	8592	8/861,8/862	Truall	162.9	80	12223	977840	Konfirmuar
18	Zef	Ndok	Boka	8592	8/635	Truall	304.9	89	12223	1087847	Konfirmuar
19	Ali	Brahim	Burgaj	8592	12/283	Truall	308.6	10	12223	122230	Konfirmuar
20	Arjan	Ragip	Zagani	8592	12/284	Truall	203.9	38	12223	464474	Konfirmuar
21	Andi	Fadil	Hallunaj	8592	12/340	Truall	640	10	12223	122230	Konfirmuar
22		Trashëgimtarët Podgorica		8591	4/1045	Truall	1503	10	8511	85110	Konfirmuar
23		Trashëgimtarët Podgorica		8591	1/1048	Truall	1825	122	8511	1038342	Konfirmuar
	SHUMA							2001.4		20630843	



Lista e objekteve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Shkodër"

Lista nr. 2

Nr.	PRONARI			Zona Kad.	Numri Pasurise	EMERTIMI I OBJEKTIT	Lloji objektit	SHENIME
	Emri	Atësia	Mbiemri			Vlera në lekë sipas preventivit		
1	Ali	Brahim	Burgaj	8592	12/283	2469367	Shtëpi Banimi	Konfirmuar ZVRPP
2	Gezim	Viktor	Tusha	8592	8/643	626419	Repart Pune(Nd.1kt)	Konfirmuar ZVRPP
3	Xhavid	Hajdar	Hallunaj	8592	12/171	808051	Dyqan (1kt)	Rikonfirmim ZVRPP
4	Adelchi	Shqipëria	Sh.p.k	8593	10/482	1103412	Mure rrethues	Konfirmuar ZVRPP
5	Marin	Ded	Majnishta	8593	13/534	5941027	lokal+shtëpi	Konfirmuar ZVRPP
6	Fran	Gjoke	Lekndreaj	8593	16/714	2226334	Shtëpi Banimi(1kt)	Certifikatë Pronësie
	SHUMA					13174610		

VENDIM**Nr. 950, datë 28.12.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR "TRE URAT
LESKOVIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tre Urat Leskovik".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "arë" dhe "pyll", me një shumë të përgjithshme prej 780 560 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, nga të cilat:

- arë, me sipërfaqe 885 m², me vlerë 84 960 (tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë;

- pyll, me sipërfaqe 6 956 m², me vlerë 695 600 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë "arë" dhe "pyll", prej 780 560 (shtatëqind

e tetëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar ZVRPP", "Vërtetim hipotekor", "Certifikatë pronësie", do të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kolonjë dhe Përmet, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kolonjë dhe Përmet të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.



11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kolonjë dhe Përmet, Drejtoria e Administrimit dhe

Mbrojtjes së Tokës dhe Këshilli i Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QE SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN " TRE URAT LESKOVIK"

NR	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Toke arë			Tokë pyll			VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip.shpr. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.shpr. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
	FSHATI GLINË Z.K. 1780 KOLONJË													
1	FANTERI	FIDARI	FIRAJ	1780	21	ARE	125	96	12000				12000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	GEZIM	REXHEP	DAJKO	1780	265	ARE	240	96	23040				23040	Konfirmuar nga ZVRPP
3	FASLI	REXHEP	DAJKO	1780	264	ARE	310	96	29760				29760	Konfirmuar nga ZVRPP
4	DALIP	BESHIR	POTKA	1780	268	ARE	210	96	20160				20160	Konfirmuar nga ZVRPP
	FSHATI ÇARÇOVË Z.K. 1356 PËRMET													
5	MYNEDET BUJAR PELLUMBESHA	QAMIL FENAI FENAI	RAMOLLI RAMOLLI RAMOLLI	1356	15-68.	PYLL				4561	100	456100	456100	Konfirmuar nga ZVRPP
6	ZIHNI ZHANETA ARMAND	XHZVIT XHAVIT XHAVIT	BORDI BORDI BORDI	1356	173.	PYLL				1500	100	150000	150000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	SHIPRESA	BEQIR	RUSI (MAZREKU)	1356	92.	PYLL				895	100	89500	89500	Konfirmuar nga ZVRPP
	Totali						885		84960	6956		695600	780560	

VENDIM

Nr. 951, datë 28.12.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGIJËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë" sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë sipërfaqe "tokë truall", me një vlerë të përgjithshme prej 46 299 060 (dyzet e gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 46 299 060 (dyzet e gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., si subjekti që garanton të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare".

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të



miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista nr. 1

LISTA E PRONAREVE TE PASURIVE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTIT PER INTERES PUBLIK "PER NDERTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGJISË"

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m2	Çmimi leke/m2	Amortizimi	Vlera (6x7x8)	Shpenzime administrative 7%	Vlera e ndërtesës	Vlere trualli	Vlera totale/leke	Gjendja juridike e pasurisë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	Nevin Godo (Vrioni)	ZK.2636	1	TRUALL	111564	415					46,299,060	46,299,060	Konfirmim nga ZVRPP
										Vlera totale		46,299,060	

VENDIM

Nr. 953, datë 28.12.2016

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN
NGA/NË DETYRË TË
ZËVENDËSKRYETARIT DHE TË NJË
ANËTARI TË KOMISIONIT TË
PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Spiro Kuro, zëvendëskryetar i Komisionit të Prokurimit Publik, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Leonard Gremshi, anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik, emërohet zëvendëskryetar i këtij komisioni.

3. Z. Odise Moçka emërohet anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 3, datë 28.12.2016

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS
MESATARE TË NDËRTIMIT TË
BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I
BANESAVE, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh", të nenit 34/1, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2016, e cila të jetë 39 281 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekë/m2 për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit, të merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.



4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t'iu referuar zonave të afërta.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr.1

Kosto mesatare e ndërtimit

Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit
3. studimit gjeologjik dhe sismik
4. lejes së ndërtimit
5. truallit
6. shpenzime operacionale të EKB 4%

NR	QYTETI	Kosto mesatare (aritmetike)	
		Sip. shfrytëzimi lekë/m ²	Sip. ndërtimi lekë/m ²
1	ELBASAN	39,154	32,331
2	GRAMSH	39,154	32,331
3	LIBRAZHID	39,232	32,393
4	PRRENJAS	39,232	32,393
5	PEQIN	39,154	32,331
6	POGRADEC	39,219	32,381
7	KORÇË	39,219	32,381
8	ERSEKË	39,426	32,552
9	TIRANË	38,881	32,113
10	DURRËS	38,884	32,105
11	KAVAJË	38,884	32,105
12	LUSHNJË	37,983	31,357
13	FIER	38,273	31,597
14	VLORË	39,358	32,508
15	BERAT	39,129	32,313
16	KUÇOVË	39,129	32,313
17	ÇOROVODË	39,129	32,313
18	PËRMET	39,504	32,614
19	TEPELENË	39,504	32,614
20	GJIROKASTËR	39,504	32,614
21	SARANDË	39,655	32,739
22	KRUJË	39,377	32,510
23	LAÇ	39,288	32,436
24	LEZHË	39,288	32,436
25	RRËSHEN	39,557	32,658
26	SHKODËR	39,533	32,642
27	PUKË	39,800	32,862
28	KUKËS	39,856	32,899
29	TROPOJË	39,856	32,899
30	BURREL	39,767	32,830
31	PESHKOPI	39,767	32,830
KOSTO MESATARE		39,281	32,432



Tabela nr.2

Vlerat mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2016 sipas qyteteve.

Nr.	Qyteti	lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1. Qarku Tiranë		
1	Tiranë	89,137
2	Vorë	51,500
3	Kamëz	52,000
4	Kavajë	51,000
5	Rrogozhinë	41,000
2. Qarku Durrës		
6	Durrës	67,500
7	Krujë	48,500
8	Shijak	41,000
9		
10	Fushë-Krujë	51,000
3. Qarku Shkodër		
11	Shkodër	58,000
12	Pukë	22,000
13	Vau Dejës	24,300
14	Koplik	40,500
15	Fushë - Arrëz	7,500
4. Qarku Vlorë		
16	Vlorë	61,800
17	Orikum	60,000
18	Selenicë	25,000
19	Himarë	58,000
20	Sarandë	56,000
21	Delvinë	26,750
22	Konispol	28,000
5. Qarku Korçë		
23	Korçë	45,800
24	Pogradec	49,900
25	Bilisht	35,000
26	Ersekë	23,000
27	Maliq	27,800
28	Leskovik	21,000
6. Qarku Fier		
29	Fier	53,100
30	Lushnjë	40,100
31	Ballsh	30,000
32	Patos	28,000
33	Divjakë	49,500
34	Roskovec	30,000
7. Qarku Berat		
35	Berat	41,400
36	Kuçovë	36,000
37	Poliçan	26,000
38	Çorovodë	25,000
39	Ura - Vajgurore	37,000
8. Qarku Elbasan		
40	Elbasan	50,300
41	Librazhd	44,000
42	Cërrik	38,300
43	Gramsh	43,000
44	Peqin	39,000
45	Përrenjas	41,780
46	Belsh	35,000
9. Qarku Gjirokastrë		
47	Gjirokastrë	47,400
48	Përmet	37,000
49	Tepelenë	32,500
50	Memaliaj	15,000



51	Këlcyrë	24,600
52	Libohovë	27,000
53	Lezhë	56,000
54	Laç	42,500
55	Mamurras	31,000
56	Rrëshen	42,000
57	Rubik	29,500
11. Qarku Kukës		
58	Kukës	54,000
59	Bajram Curri	27,900
60	Krumë	24,500
12. Qarku Dibër		
61	Peshkopi	49,000
62	Burrel	44,300
63	Bulqizë	41,800
64	Klos	32,000
Njësitë Administrative		
65	Nj.Adm. Shëngjin	56,000
66	Nj.Adm. Milot	34,000
67	Nj.Adm. Krrabë	28,200
68	Nj.Adm. Kashar	53,500
69	Nj.Adm.Dajt	53,500
70	Nj.Adm. Farkë	66,500

Tabela nr. 3

Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2016

Nr.	Zonat	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1	1/1	97,700
2	1/2	78,000
3	2/1	187,000
4	2/2	134,500
5	2/3	95,000
6	2/4	110,000
7	2/5	80,000
8	3/1	77,000
9	3/2	60,000
10	4/1	70,000
11	4/2	60,000
12	5/1	190,000
13	5/2	132,000
14	5/3	107,000
15	5/4	82,000
16	6	65,000
17	7/1	120,000
18	7/2	100,000
19	7/3	85,000
20	7/4	65,000
21	8/1	110,000
22	8/2	100,000
23	8/3	72,000
24	9/1	130,000
25	9/2	100,000
26	9/3	77,000
27	10/1	145,000
28	10/2	139,500
29	10/3	102,000
30	11/1	87,000
31	11/2	75,000
32	11/3	70,000

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 374 lekë